

REGJISTRIMI I BUJQËSISË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS 2014

Raporti i Cilësisë



LE GOUVERNEMENT
DU GRAND-DUCHÉ DE LUXEMBOURG
Coopération luxembourgeoise

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK



Raporti i Cilësisë
Regjistrimi i Bujqësisë 2014

Botuesi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Data e botimit: Nëntor, 2015

©: **Agjencia e Statistikave të Kosovës**

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

Më shumë informata mund të gjeni në ueb-faqen e ASK-së në internet:

<http://ask.rks-gov.net>

Përmbajtja

Parathënie	5
1. Shpjegime metodologjike	9
1.1. Qëllimi i Regjistrimit të Bujqësisë.....	9
1.2. Baza ligjore	9
1.3. Njësitë e Regjistrimit të Bujqësisë.....	9
1.4. Mbulueshmëria e Regjistrimit të Bujqësisë	10
1.5. Periudhat referuese	11
1.6. Instrumentet e Regjistrimit të Bujqësisë.....	11
1.7. Kryerja e punës në terren.....	12
1.8. Struktura organizative e punës në terren	13
1.8.1. Trajnimet e stafit në terren.....	14
1.8.2. Mbledhja e të dhënave	14
1.8.3. Monitorimi i mbledhjes së të dhënave	14
1.9. Variablat kryesore dhe statistikat kryesore	15
1.9.1. Përkufizimet e variablave kryesore dhe të statistikave kryesore	15
2. Vlerësimi i cilësisë së Regjistrimit të Bujqësisë	17
2.1. Pyetësi i Anketës Pas Regjistrimit	18
2.2. Dizajni i mostrës	18
2.3. Mbledhja e të dhënave në APR.....	19
2.4. Përfshirja dhe pastrimi i të dhënave	20
2.5. Aplikacioni për përfshirjen e të dhënave të APR-së.....	20
3. Dimensionet e cilësisë dhe treguesit e cilësisë së RB 2014.....	20
3.1. Relevanca	20
3.2. Pjesa e statistikave që mungojnë.....	21
4. Saktësia e vlerësimeve.....	21
4.1. Gabimet në mostër (Sampling errors).....	21
4.2. Gabimet jo në mostër (Non sampling errors)	22
4.3. Gabimi i mospërgjigjes	22
4.4. Shkalla e mospërgjigjes së njësisë.....	22

4.5.	Shkalla e pastrimit dhe imputimit	23
4.6.	Trajtimi i mospërgjigjes së njësisë.....	24
4.7.	Gabimi në mbulueshmëri	24
4.7.1.	Gabimi në mbi-mbulueshmëri të kornizës.....	24
4.7.2.	Gabimi i nën-mbulueshmërisë dhe mbi-raportimit.....	25
4.8.	Gabimet në matje.....	26
4.8.1.	Burimi i gabimeve në matje	27
4.8.2.	Trajtimi i gabimeve në matje	28
4.8.3.	Masat e ndërmarra për zvogëlimin e gabimeve në matje.....	28
5.	Afatet kohore dhe përpikëria	28
5.1.	Afatet kohore	28
5.2.	Përpikëria	29
5.3.	Arsyet për vonesa dhe masat e ndërmarra për shkurtimin e vonesave.....	29
6.	Qasja dhe qartësia	29
6.1.	Qasja.....	29
6.2.	Qartësia	30
7.	Krahasueshmëria	30
7.1.	Krahasueshmëria në kohë	30
7.2.	Krahasueshmëria gjeografike	31
8.	Koherenca.....	31
8.1.	Koherenca e brendshme	31
8.2.	Koherenca me burimet tjera	32
9.	Kostoja dhe ngarkesa mbi të anketuarit.....	33
10.	Konfidencialiteti	33

Parathënie

Raporti i cilësisë plotëson të dhënat e shpërndara të Regjistrimit të Bujqësisë 2014 dhe ofron një pasqyrë të dimensioneve të cilësisë së Regjistrimit të Bujqësisë 2014 në Kosovë.

Në nëntor të vitit 2014, në Republikën e Kosovës u realizua Regjistrimi i Bujqësisë, pas më shumë se 50 vjetësh. Regjistrimi i Bujqësisë, për herë të fundit ishte kryer në vitin 1960. Metodologjia e Regjistrimit të Bujqësisë 2014 është në përputhje me standardet ndërkombëtare të Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë (ang. FAO) dhe me legjislacionin e BE-së: Rregulloren (EC) Nr. 1166/2008 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian për anketat e strukturës së fermës dhe anketën për metodat e prodhimit bujqësor, si dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit Evropian (EEC) 571/88. Regjistrimi i Bujqësisë është anketa themelore statistikore në statistikat bujqësore, ku mblidhen të dhënat për strukturën e fermës. Në përputhje me rekomandimet e Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO), Regjistrimi i Bujqësisë duhet të bëhet çdo dhjetë vjet. Edhe në vendet e BE-së, në bazë të legjislacionit të BE-së, Regjistrimi i Bujqësisë është i obliguar të kryhet në çdo dhjetë vjet. Deri më tani, politikat dhe strategjitë në Republikën e Kosovës janë bazuar në të dhënat nga komunitatet dhe anketat e ish-Entit të Statistikave të Kosovës (tani Agjencia e Statistikave të Kosovës), të cilat janë mbledhur përmes metodologjive të ndryshme. Në kuadër të Regjistrimit të Popullsisë, të realizuar në prill të vitit 2011, ishin përfshirë disa pyetje lidhur me bujqësinë, shfrytëzimin e tokës dhe blegtorinë. Realizimi i Regjistrimit të Bujqësisë në vitin 2014 ofron informacione të detajuara strukturore për bujqësinë, në bazë të të cilave mund të zhvillohen politika të reja për zhvillimin ekonomik në sektorin e bujqësisë.

Të dhënat ofrojnë një kornizë për kryerjen e anketave të rregullta dhe së bashku me regjistrimin do të përbëjnë shtyllën kryesore të sistemit të statistikave bujqësore që mbulojnë nevojat kombëtare dhe standardet ndërkombëtare.

Regjistrimi ishte përgatitur të kryhet në tërë territorin e vendit, por katër (4) komunitatet me shumicë etnike serbe (Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq) refuzuan të marrin pjesë. Prandaj, të dhënat janë publikuar vetëm për 34 komuna. Regjistrimi i Bujqësisë është organizuar dhe kryer nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) dhe Komisionet Komunale të Regjistrimit (KKR). Ky projekt është financuar nga Fondi i Mirëbesimit, i themeluar nga Qeveria e Kosovës dhe Zyra e BE-së në Kosovë, me pjesëmarrjen e donatorëve të tjerë ndërkombëtarë, siç janë SIDA, DFID, SDC, Qeveria e Luksemburgut dhe Qeveria e Danimarkës. Fondi i Mirëbesimit është menaxhuar nga UNOPS-i.

Të dhënat janë mbledhur gjatë periudhës 1-20 nëntor 2014, duke përdorur pyetësorë në letër për grumbullimin e të dhënave përmes intervistës ballë-për-ballë. Në zonat rurale, të dhënat janë mbledhur duke përdorur metodën derë-më-derë, ndërsa në zonat urbane kornizë për mbledhjen e të dhënave ishte Lista e Ekonomive Bujqësore nga Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2011. Po ashtu, janë intervistuar të gjitha subjektet juridike me aktivitet bujqësor.

Cilësia e të dhënave ishte vlerësuar me anë të mjeteve dhe metodave të ndryshme (APR, vlefshmërisë së të dhënave, analizave të përgjigjeve). Treguesit kryesor të cilësisë tregojnë se cilësia e të dhënave mund të konsiderohet mjaftë e lartë dhe e pranueshme sipas shumicës së kritereve të caktuara.

Shkalla e papeshuar e mospërgjigjes ishte 2.8%, ndërsa shkalla e peshuar e mospërgjigjes ishte 2.4 %.

Mbulueshmëria e RB-së është ndikuar gjithashtu nga të dhënat që mungojnë për katër komuna. Regjistrimi i Bujqësisë nuk ka mundur të zhvillohet në komunat në pjesën veriore të Kosovës (Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicën Veriore), për shkak të refuzimit të këtyre komunave që të marrin pjesë në regjistrim.

Për territorin që ishte mbuluar, APR ka treguar një gabim të pranueshëm në mbulueshmëri. Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore ishte nënvlerësuar për 4.9 %, ndërsa numri i gjedheve për 2.7%. Gabimi i mbi-raportimit ka balancuar shumicën e gabimeve në nën-mbulueshmëri, prandaj të dhënat e përgjithshme që kanë të bëjnë me variablat kryesore ishin nënvlerësuar në masë të vogël; sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore për 0.3% dhe gjedhet për 1.7%.

Po ashtu, sa i takon matjes së gabimeve nuk është hasur në ndonjë gabim të theksuar për variablat kryesore; sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore ishte mbivlerësuar për 1.1 % dhe gjedhet për 1.7%.

Lista e shkurtesave dhe simboleve

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
APR	Anketa Pas Regjistrimit
BE	Bashkimi Evropian
DFID	Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar i Mbretërisë së Bashkuar
EB	Ekonomi Bujqësore
AEFB	Anketa e Ekonomive Familjare Bujqësore
FAO / UN	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqim dhe Bujqësi
KE	Komisioni Evropian
KKR	Komisioni Komunal i Regjistrimit
KR	Komisioni i Regjistrimit
KV	Koeficienti i variacionit (ndryshimit)
LRB	Lista e Regjistrimit të Bujqësisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
NJB	Njësia Blegtorale
NJPV	Njësia e Punës Vjetore
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
QR	Qarku Regjistruar
RB	Regjistrimi i Bujqësisë
RD	Raporti ditor
RPEFB 2011	Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2011
SB	Subjekte Juridike
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
SIDA	Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim
UNOPS	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime të Projekteve
%	Përqindje
ha	Hektar

1. Shpjegime metodologjike

1.1. Qëllimi i Regjistrimit të Bujqësisë

Qëllimi i Regjistrimit të Bujqësisë është:

Të ofrojë informacion statistikor të saktë për një numër të gjerë të karakteristikave, për të gjitha njësitë që kryejnë aktivitete bujqësore në territorin e Republikës së Kosovës dhe që t'i vë ato në dispozicion për publikun e përgjithshëm dhe për përdoruesit e specializuar (hulumtuesit, politikëbërësit, etj.).

Të ofrojë informacion statistikor të saktë dhe të freskuar, për një numër të madh të karakteristikave në nivel të komunës, për nevojat e autoriteteve vendore.

Të krijojë Regjistrin Statistikor të Fermave, si bazë për kryerjen e anketave statistikore për ekonomitë bujqësore.

T'i ofrojë Qeverisë informacion bazë për projektimin, planifikimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme dhe specifike, për ta mbështetur zhvillimin e bujqësisë në nivel lokal dhe kombëtar.

1.2. Baza ligjore

Legjislacioni bazë për zbatimin e Regjistrimit të Bujqësisë në Kosovë është:

Ligji Nr. 04/L-036 i 21 tetorit 2011 për "Statistikat Zyrtare";

Ligji për Regjistrimin e Bujqësisë Nr.04/L-127 (Gazeta Zyrtare, Nr.1/2013/17.01.2013), Ligji Nr. 04/L-253 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-127 për Regjistrimin e Bujqësisë (Gazeta Zyrtare, Nr. 32/2014/15.05.2014);

Metodologjia e Regjistrimit të Bujqësisë 2014 është në përputhje me legjislacionin e BE-së: Rregulloren (EC) Nr. 1166/2008 e Parlamentit dhe të Këshillit Evropian për anketat e strukturës së fermës dhe Anketën për Metodat e Prodhimit Bujqësor, si dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit Evropian (EEC) 571/88.

1.3. Njësitë e Regjistrimit të Bujqësisë

Njësitë e regjistrimit janë ekonomitë bujqësore.

Ekonomia bujqësore është një njësi e pavarur teknike dhe ekonomike e prodhimit, në të cilën një (1) ekonomi familjare ose (2) subjekt juridik kryen (3) veprimtari bujqësore, si aktivitet kryesor ose dytësor, nën një menaxhim të vetëm dhe ku i përdorin mjetet e përbashkëta të prodhimit (tokën, pajisjet, ndërtesat, etj.).

(1) Ekonomia familjare nënkupton individin, bashkësinë familjare ose bashkësinë tjetër të personave (individëve), të cilët jetojnë së bashku dhe janë të vendosur tërësisht ose pjesërisht në një ekonomi familjare, si dhe furnizohen me gjëra ushqimore e gjëra të tjera elementare për

jetesë. Anëtarët e këtij grupi mund t'i bashkojnë të ardhurat e tyre në një masë më të madhe ose më të vogël.

Ekonomi familjare bujqësore është një familje ose komunitet i njerëzve, anëtarët e së cilës janë të angazhuar në prodhimtari bujqësore, si aktivitet të tyre kryesor ose dytësor, kanë një menaxhim të vetëm dhe i përdorin mjetet e përbashkëta të prodhimit, të tilla, si: tokën, makinat, ndërtesat, etj. Një ekonomi familjare bujqësore mund të prodhojë produkte bujqësore për shitje, konsum vetanak ose për të dyja.

(2) Subjektet juridike janë kooperativat bujqësore, bizneset individuale dhe format e tjera organizative, me statusin e subjektit juridik, që janë të regjistruara se kanë prodhimtari bujqësore, si aktivitet të tyre kryesor dhe ndërmarrjet, institucionet dhe subjektet e tjera juridike, të cilat janë të regjistruara në një aktivitet tjetër dhe të cilat kanë degë organizative ose pjesë të tjera organizative, ku kryhet prodhimtaria bujqësore.

(3) Veprimtaria bujqësore nënkupton:

- Kultivimin e kulturave bujqësore (drithëra, patate, bishtajore të thata me kokërr, duhan, bimë foragjere, perime, lule, bimë dekorative, farëra, fidane, pemë, rrush, kërpudha, etj.);
- Rritjen e bagëtisë, shpezëve dhe kafshëve të tjera për mbarështim (gjedhe, derra, dele, dhi, njëthundrakë (kuaj, gomarë, mushka), pula, bletë, lepuj, etj.); dhe
- Prodhimin e verës nga rrushi i prodhuar në Ekonominë Bujqësore.

Po ashtu, janë përfshirë edhe ekonomitë në vijim:

- Ekonomitë bujqësore të instituteve kërkimore, komunitetet fetare, shkollat dhe burgjet, që merren me prodhimtari bujqësore;
- Ekonomitë bujqësore, të cilat janë pjesë e ndërmarrjeve industriale;
- Ekonomitë bujqësore, që merren me blegtori, por në ditën referuese nuk kanë bagëti; ekonomia është përkohësisht bosh, për shkak të ndërprerjes së përkohshme të ciklit të prodhimit (pastrimi sanitar i stallave për blegtori, përhapja e ndonjë sëmundjeje apo për arsye të ngjashme).

Prodhimi bujqësor nuk përfshin:

- mbajtjen e kuajve për gara, pa aktivitet të mbarështimit;
- përpunimin e prodhimeve bujqësore (duke përjashtuar prodhimin e verës së prodhuar nga rrushi i kultivuar në ekonomi);
- pylltarinë, gjuetinë, peshkimin ose kultivimin e peshkut; dhe
- kryerjen e shërbimeve bujqësore me makinat e veta për ekonomitë e tjera bujqësore.

1.4. Mbulueshmëria e Regjistrimit të Bujqësisë

Në Regjistrimin e Bujqësisë janë përfshirë vetëm ekonomitë bujqësore, të cilat e kanë plotësuar të paktën një nga kriteret e mëposhtme:

- Ekonomia punon 10 ari (1 000 m²) ose më shumë tokë bujqësore të shfrytëzuar për kultivimin e kulturave bujqësore; ose
- Ekonomia prodhon perime, lule ose produkte të tjera bujqësore në serra për shitje; ose
- Ekonomia mban një ose më shumë gjedhe ose kuaj; ose
- Ekonomia mban të paktën 3 derra të rritur; ose
- Ekonomia mban të paktën 4 krerë të rritur të deleve ose dhive dhe derrave së bashku; ose
- Ekonomia mban të paktën 50 shpezë të rritura dhe lepuj femra së bashku; ose
- Ekonomia mban të paktën 20 koshere bletësh; ose
- Ekonomia prodhon kërpudha për shitje.

Të dhënat e mbledhura në Regjistrimin e Bujqësisë:

Për ekonomitë familjare bujqësore: emri i bartësit të ekonomisë, gjinia, numri personal i identifikimit, mosha, e-maili, numri i telefonit;

Për subjektet bujqësore: emri i subjektit juridik, numri i regjistrimit të subjektit juridik, e-maili, vendndodhja dhe numri i telefonit.

Për të gjitha llojet e ekonomive bujqësore, duke përfshirë ekonomitë familjare bujqësore:

- Të dhënat për vendndodhjen e ekonomisë dhe numri i identifikimit në MBPZHR;
- Të dhënat për sipërfaqen e përgjithshme të tokës së ekonomisë, sipërfaqen e shfrytëzuar bujqësore, prej saj sipërfaqen e tokës në pronësi, sipërfaqen e tokës së marrë me qira dhe forma të tjera të qiradhënies së tokës; sipërfaqja e pashfrytëzuar nga ekonomia;
- Të dhënat për shfrytëzimin e tokës bujqësore sipas kulturave individuale;
- Të dhënat për bagëtinë sipas llojeve dhe kategorive;
- Të dhënat për makinerinë bujqësore, pajisjet dhe ndërtesat;
- Të dhënat për fuqinë punëtore të ekonomisë bujqësore;
- Të dhënat për shitjen e produkteve bujqësore, prodhimeve bujqësore organike, aktivitete të tjera fitimprurëse;
- Të dhënat për metodat e prodhimit bujqësor;
- Të dhënat për masat e zhvillimit rural;
- Të dhënat e sipërfaqes me pyje brenda ekonomisë.

1.5. Periudhat referuese

Të dhënat për sipërfaqen e tokës së shfrytëzuar dhe për fuqinë punëtore i referohen vitit bujqësor, **31 tetor 2013 - 1 nëntor 2014**.

Të dhënat për numrin e kafshëve i referohen numrit të kafshëve në ekonomi bujqësore, **më 1 nëntor të vitit 2014**.

1.6. Instrumentet e Regjistrimit të Bujqësisë

Instrumentet teknike për Regjistrimin e Bujqësisë (Pyetëtori dhe Udhëzuesi) janë hartuar në përputhje me Programin Botëror për Regjistrimin e Bujqësisë 2010 (FAO - UN) dhe metodologjinë e Eurostat-it për kryerjen e anketës së strukturës së fermave: Rregulloren (EC) Nr. 1166/2008 dhe

Rregulloren (EC) Nr.1200/2009. Përmbajtja e pyetësorit të Regjistrimit të Bujqësisë ka mbuluar edhe nevojat specifike kombëtare.

Një pyetësor i vetëm është përdorur për ekonomitë familjare bujqësore dhe subjektet juridike. Pyetësorët kanë qenë të shtypur në letër me të dhëna identifikuese, të shtypura paraprakisht: bar-kodet, kodin unik të pyetësorit, emrin, mbiemrin dhe adresën e ekonomisë familjare bujqësore/subjektit juridik (numrin e ndërtesës, vendbanimit, komunës).

Udhëzuesi i Regjistrimit të Bujqësisë përmban të gjitha shpjegimet e nevojshme për qëllimin e regjistrimit, konceptet, përkufizimet dhe detajet për detyrat e pjesëmarrësve në Regjistrimin e Bujqësisë. Ai jep informacion të detajuar se si të plotësohet pyetësori dhe si të përdoren instrumentet e tjera të regjistrimit (raportet ditore dhe përmbledhëse, lista e regjistrimit të bujqësisë, hartat, etj.). Të gjithë pjesëmarrësit në Regjistrimin e Bujqësisë kanë qenë të obliguar t'i respektojnë udhëzimet.

Personeli i regjistrimit kanë qenë të pajisur edhe me dokumente të tjera mbështetëse: harta, raporte ditore (RD), letër informuese, letër njoftuese, raportin e pranimit-dorëzimit, listën e ekonomive/subjekteve juridike për t'u vizituar (LRB).

Hartat e tërë territorit të Kosovës janë përgatitur nga ASK-ja, bazuar në imazhet satelitore nga tetori i vitit 2010, si dhe të freskuara më të dhënat e terrenit nga Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në vitin 2011. Hartat kanë mbuluar qarqet regjistruese (QR), për të cilat regjistruerit, kontrollorët, mbikëqyrësit ose KKR-të ishin përgjegjëse.

Të gjitha instrumentet e RB-së dhe organizimi i punës në terren është testuar me Regjistrimin Testues të Bujqësisë, i cili është kryer në nëntor të vitit 2012 në të gjitha komunat e Kosovës, ku janë përfshirë rreth 1 600 ekonomi familjare. Përveç ekonomive familjare edhe nga 2 subjekte juridike, që merren me bujqësi janë intervistuar në secilën komunë.

Regjistrimi Testues ka ofruar informacion të nevojshëm për t'i finalizuar instrumentet e RB-së, për t'i planifikuar trajnimet, për ta planifikuar organizimin përfundimtar të punës në terren dhe për ta përgatitur sistemin për përfshirjen e të dhënave dhe procesin e pastrimit të të dhënave. Përveç kësaj, në Regjistrimin Testues të RB-së është trajnuar i gjithë stafi i zyrave rajonale të ASK-së.

1.7. Kryerja e punës në terren

Puna në terren është realizuar në përputhje me Ligjin për Regjistrimin e Bujqësisë dhe në bazë të përvojës së fituar në Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2011, si dhe në Regjistrimin Testues.

Gjatë punës në terren kanë marrë pjesë 2 797 regjistruer (prej tyre 228 rezervë), 496 kontrollorë (prej tyre 63 rezervë) dhe 71 mbikëqyrës (prej tyre 9 rezervë) dhe 155 anëtarë të KKR-ve.

Mbikëqyrësit dhe kontrollorët janë rekrutuar nga ASK-ja, përderisa regjistruerit janë rekrutuar nga komunat duke ndjekur udhëzimet e ASK-së. Kandidatët është dashur t'i përmbushin kriteret themelore, si: shkollimi, përvoja e punës, njohja e gjuhës përkatëse dhe që të jenë banorë në vendbanimin përkatës, ku ata/ato janë menduar të punojnë. Të gjithë kandidatët, paraprakisht, janë testuar, ndërsa përparësi iu është dhënë kandidatëve me përvojë në lëminë e bujqësisë.

1.8. Struktura organizative e punës në terren

I tërë organizimi i punës në terren është bazuar në ndarjen e territorit të Kosovës në qarqe regjistruese (QR), që mundësoi që: regjistruesit të ngarkohen me punë përafërsisht në mënyrë të barabartë; mbledhja e të dhënave të përfundojë në kohën e paraparë; dhe të gjitha ekonomitë familjare të jenë në gjendje t'i japin përgjigjet në gjuhën që e flasin.

Të dhënat e Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave të vitit 2011 janë shfrytëzuar si kornizë për përgatitjen e RB-së.

Para Regjistrimit të Popullsisë të vitit 2011, Agjencia e Statistikave të Kosovës e ka ndarë territorin e banuar të Kosovës në 4 677 njësi të vogla gjeografike, të quajtura qarqe regjistruese. Qarku regjistrues është njësia më e vogël gjeografike për mbledhjen e të dhënave në terren. Numri i ekonomive familjare në një QR është përshtatur me nevojat për mbledhjen e të dhënave në Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave, ku ishte planifikuar se një regjistrues mund t'i mbledhë të dhënat nga një QR gjatë kohës prej dy javësh.

ë Regjistrimin e Bujqësisë, periudha e mbledhjes së të dhënave ka qenë më e gjatë sesa në Regjistrimin e Popullsisë (6 ditë më tepër), dhe kohëzgjatja e intervistës ishte e ndryshme. Bazuar në Regjistrimin Testues të vitit 2012, është vlerësuar se një person mund t'i regjistrojë rreth 70 ekonomi familjare në zonat urbane dhe rreth 100 ekonomi familjare në zonat rurale. Me vendim administrativ të komunës, zonat rurale dhe urbane në Kosovë janë të definuara në nivel të vendbanimit.

Zona rurale është zonë gjeografike, jo e urbanizuar, që karakterizohet me dendësi të ulët të popullsisë dhe zakonisht, shumica e tokës përdoret kryesisht për bujqësi. Ndërsa, zona urbane karakterizohet me dendësi të lartë të popullsisë dhe objekte të mëdha.

Sipas parimit të sipërpërmendur, territori i banuar i Kosovës për Regjistrimin e Bujqësisë është ndarë në 2 640 zona regjistruese, ku një zonë regjistruese ishte e barabartë me një ose më shumë qarqe regjistruese. Çdo zonë e kishte kodin e vet unik dhe është përdorur si njësi themelore për organizimin e aktiviteteve të tjera, si: dokumenteve të trajnimit, raporteve, shpërndarjen dhe mbledhjen e materialeve të regjistrimit dhe pagesave për regjistruesit në terren. Për secilën zonë regjistruese ishte caktuar regjistruesi, që flet gjuhën e popullsisë dhe që jeton në atë zonë regjistruese. Në zonat etnikisht të përziera janë caktuar dy ose më shumë regjistrues, të etnive përkatëse.

Për çdo zonë regjistruese është përgatitur lista e ekonomive familjare, e quajtur lista e regjistrimit të bujqësisë (LRB). LRB-ja përfshinte ekonomitë e mundshme bujqësore në Kosovë. Burimi kryesor për hartimin e LRB-së ishte baza e të dhënave e Regjistrimit të Popullsisë 2011. Në Regjistrimin e Popullsisë 2011 disa të dhëna për bujqësinë janë mbledhur, me qëllimin kryesor për ta siguruar kornizën për RB-në. Për komunat, ku Regjistrimi i Popullsisë 2011 nuk është kryer, është përdorur korniza e përgatitur për Regjistrimin e Popullsisë (e azhurnuar në vitin 2008-2010). Për komunat, në të cilat Regjistrimi i Popullsisë 2011 është kryer pjesërisht, janë përdorur të dhënat nga korniza e Regjistrimit të Popullsisë të vitit 2011 dhe të dhënat e azhurnuara në vitin 2008-2010.

Për subjektet juridike burim për përgatitjen e LRB-së ishte Regjistri i Bizneseve i ASK-së.

Regjistrimi Testues i RB-së në vitin 2012 tregoi se lista e ekonomive familjare me veprimtari bujqësore nuk është e plotë në të gjitha vendbanimet. Nga baza e të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2011 është konstatuar se në zonat rurale, shumica e ekonomive familjare kryejnë aktivitet bujqësor, ndërsa në zonat urbane janë të rralla ekonomitë familjare me aktivitet

bujqësor. Për të garantuar mbulueshmëri të mirë, LRB-të në zonat rurale kanë përfshirë të gjitha ekonomitë familjare (bujqësore dhe jobujqësore). Në zonat urbane, LRB-të kanë përfshirë vetëm ekonomitë familjare, që në Regjistrimin e Popullsisë së vitit 2011 kanë deklaruar se merren me aktivitete bujqësore (mbi pragun e përdorur në RB), pasi intervistimi i të gjitha ekonomive familjare nuk do të ishte real dhe nuk do t'i kontribuonte shumë mbulueshmërisë. LRB-të ka përfshirë gjithashtu të gjitha subjektet juridike të regjistruara me aktivitetet bujqësor.

Regjistruerit kanë pasur për detyrë t'i vizitojnë të gjitha ekonomitë familjare/subjektet juridike në LRB. Për më shumë, me qëllim që të fitohej mbulueshmëri më e mirë, janë intervistuar dhe janë përfshirë në LRB dhe harta edhe ekonomitë e reja familjare, që identifikoheshin në terren, në zonat rurale, pavarësisht nëse ato kryejnë aktivitete bujqësore ose jo, dhe pa marrë parasysh nëse ato e arrijnë pragun ose jo. Në zonat urbane janë vizituar vetëm ekonomitë familjare që kanë qenë në listë.

1.8.1. Trajnimet e stafit në terren

Anëtarët e KKR-ve janë trajnuar për dy (2) ditë nga stafi i ASK-së. Trajnimet janë mbajtur dy muaj më parë në qendrat rajonale.

Trajnimet e stafit në terren janë realizuar me metodën "Kaskadë". Ekipi i Metodologjisë së Regjistrimit të Bujqësisë ka trajnuar mbikëqyrësit, mbikëqyrësit kanë trajnuar kontrollorët dhe kontrollorët kanë trajnuar regjistruerit. Trajnimi ka zgjatuar nga pesë (5) ditë për secilin nivel.

Mbikëqyrësit janë trajnuar në ASK, kontrollorët në salla të komunave, ndërsa regjistruerit në 147 vende të siguruar nga KKR-të, dhe mesatarisht rreth 20 regjistruer janë trajnuar në të njëjtën sallë.

Trajnimet janë mbajtur në gjuhën shqipe, serbe dhe turke. Trajnimet janë mbajtur, duke përdorur materialin e njëjtë të trajnimit (PPP). Të gjitha trajnimet janë mbikëqyruar nga ekipi i metodologjisë nga ASK-ja dhe KKR-të. KKR-të i kanë siguruar sallat për trajnime dhe kanë ofruar asistencë teknike për trajnimet.

1.8.2. Mbledhja e të dhënave

Mbledhja e të dhënave është bërë në periudhën 1-20 nëntor 2014.

Mbledhja e të dhënave është kryer me metodën "derë-më-derë" dhe duke përdorur metodën e intervistimit ballë-për-ballë. Metoda "derë-më-derë" është mbështetur nga LRB-të dhe hartat përkatëse me ndërtesat me numra. Të dhënat janë mbledhur nga regjistruerit në gjuhën shqipe, serbe ose turke, sipas përkatësisë etnike dhe gjuhës amtare të anëtarëve të ekonomisë familjare.

1.8.3. Monitorimi i mbledhjes së të dhënave

Puna në terren është monitoruar në nivele të ndryshme. Niveli i parë i kontrollit është kryer nga kontrollorët, të cilët duhej të komunikonin çdo ditë me regjistruerit dhe t'i kontrollonin të gjithë pyetësorët. Në rast nevojë, ata kanë kërkuar bërjen e korigjimeve, duke përfshirë edhe

përsëritjen e intervistës. Mbikëqyrësit kanë qenë në kontakt çdo ditë, me kontrollorët dhe kanë pasur për detyrë t'i kontrollonin 10% të pyetësorëve.

Puna e mbikëqyrësve është monitoruar dhe është koordinuar nga ASK-ja dhe anëtarët e KKR-ve, në veçanti nga anëtarët e zyrave rajonale të statistikës.

I tërë procesi është monitoruar dhe është koordinuar nga ekipi i ASK-së, i cili ka vizituar çdo ditë komunat e ndryshme, është takuar me stafin në terren dhe me anëtarët e KKR-ve, ka bërë vlerësimin e disa pyetësorëve, dhe çdo ditë ka diskutuar problemet në terren dhe ka ofruar mbështetje në zgjidhjen e problemeve metodologjike dhe logjistike.

1.9. Variablat kryesore dhe statistikat kryesore

Variablat kryesore të RB ishin si në vijim:

Toka e punueshme, drithërat kokërr, gruri, misri kokërr, patatet, sipërfaqja me vreshta, sipërfaqja e plantacioneve të pemëve, livadhet dhe kullotat e përhershme, gjedhet, lopët qumështore, delet për mbarsim (femra), dhitë për mbarsim (femra), gjithsej shpezët.

Statistikat kryesore të RB ishin si në vijim:

Gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar bujqësore, gjithsej njësitë blegtorale, gjithsej njësitë e punës vjetore, sipërfaqja mesatare e shfrytëzuar e tokës bujqësore për ekonomi bujqësore, njësitë blegtorale mesatare për ekonomi bujqësore, njësitë mesatare të punës vjetore për ekonomi bujqësore.

1.9.1. Përkufizimet e variablave kryesore dhe të statistikave kryesore

VARIABLAT KRYESORE:

Tokë e punueshme është sipërfaqja e tokës, e cila është kultivuar rregullisht me kultura të ndryshme bujqësore ose është mbjellë me një renditje të caktuar të kulturave (sistemi i qarkullimit të kulturave). Sipërfaqja e tokës së punueshme të shfrytëzuar i referohet sipërfaqes kryesore gjatë vitit bujqësor (31 tetor 2013 -1 nëntor 2014).

Drithëra kokërr - përfshihet sipërfaqja e drithërave, e korrur për kokërr, pavarësisht përdorimit të tyre (për konsum njerëzor ose ushqim të kafshëve në EB, për shitje ose për farë). Sipërfaqja me drithëra kokërr iu referohet bimëve të korrura në vitin 2014, edhe nëse ato janë mbjellë në vjeshtë të vitit 2013 (p.sh. gruri dhe thekra). Sipërfaqet me drithëra të gjelbra kokërr për ushqimin e kafshëve janë të përfshira në kategorinë "Kultura foragjere".

Misër kokërr - përfshihet misri i korrur me dorë, me makinë zhveshëse misri ose korrja e kombinuar, pavarësisht përdorimit, përfshirë edhe kokrrat për silazh. Gjithashtu, këtu përfshihen edhe kokrrat e korrura së bashku me kalli, por me lagështi më të madhe se 20% dhe që përdoren për silazh (të quajtura përzierje kokërr-kalli). Kallinj të misrit të ëmbël për konsum njerëzor janë përfshirë në perime të tjera.

Patatet përfshijnë patatet e hershme, patatet e vonshme dhe patatet për farë, në tokën e punueshme, si për nevoja të veta, ashtu edhe për shitje në treg.

Plantacionet e vreshtave janë sipërfaqe me hardhi rrushi me një distancë të caktuar ndërmjet rreshtave dhe ndërmjet hardhive, të cilat mundësojnë përdorimin e makinave dhe pajisjeve bujqësore, si dhe aplikimin e masave agroteknike.

Plantacionet e pemëve janë sipërfaqe me pemë frutore, të mbjella në rreshta dhe me një distancë të caktuar ndërmjet rreshtave, që mundësojnë përdorimin e makinave dhe pajisjeve për pemishte, dhe ku zakonisht ndërmerren masat agroteknike. Zakonisht, këto janë plantacione të mëdha të pemëve.

Livadhet janë sipërfaqe të tokës së kultivuar me kultura të përhershme (për pesë vjet ose më shumë) për rritjen e barojave të ndryshme të kultivuara (të mbjella) ose në mënyrë natyrale (vetëmbjella) dhe që nuk janë të përfshira në qarkullimin e kulturave në EB. Livadhet mund të përdoren për kullotje, ose kositje për sanë a silazh.

Kullotat (kullotat natyrore) janë tokë e përdorur për kullotje, zakonisht në sipërfaqe të tokës me cilësi të ulët, për shembull në tokat kodrinore dhe me lartësi të madhe mbidetare, zakonisht të pajtuara me masa agroteknike. Këto sipërfaqe, zakonisht përdoren për kullotje ekstensive dhe zakonisht nuk kositen ose kositen në mënyrë klasike. Këto sipërfaqe nuk janë të përshtatshme për numër të madh të kopeve të bagëtive. Këtu janë të përfshira, gjithashtu edhe kullotat: intensive (tokat e ulëta) dhe ekstensive (tokat kodrinore).

Toka e përbashkët është toka, që nuk i takon drejtpërsëdrejti EB-së, por që në të aplikohen të drejtat e përbashkëta. Ajo mund të përbëhet nga kullotat, livadhet ose toka tjetër. Në përgjithësi, toka e përbashkët është toka e shfrytëzuar bujqësore në pronësi të një autoriteti publik (shtetëror, komunal) mbi të cilën një person mund t'i ushtrojë të drejtat e përbashkëta dhe këto të drejta ushtrohen në përgjithësi, në mënyrë të përbashkët me të tjerët.

Gjedhet – përfshimi të gjitha llojet e gjedheve.

Lopët qumështore janë lopë që kanë pjellë tashmë (përfshirë edhe ato të moshës më pak se dy vjeç) dhe që për shkak të racës së tyre, ose cilësive të veçanta, mbahen kryesisht për të prodhuar qumësht për konsum njerëzor, ose për përpunimin e qumështit. Këtu përfshihen edhe lopët për qumësht, në fund të aftësisë së tyre prodhuese, që momentalisht nuk mbahen për prodhimin e qumështit, por kanë dalë nga prodhimtaria e qumështit (laktacioni) dhe janë të destinuara për therrje, pavarësisht se a janë majmur në periudhën ndërmjet laktacionit të fundit dhe therrjes së tyre.

Dele për mbarsim - përfshini numrin e deleve femra për mbarështim të cilat janë:

- Dele që tashmë kanë pjellë qengja
- Dele të mbarësuara për herë të parë- janë dele që janë mbarësuar për herë të parë dhe të cilat pritet të pjellin qengjat e parë.

Dhi femra për mbarsim - përfshini numrin e dhive femra për mbarështim të cilat janë:

- Dhi që tashmë kanë pjellë keca
- Dhi të mbarësuara për herë të parë dhe që pritet të pjellin kecat e parë.

Shpezë - përfshini të gjitha llojet e shpezëve. Zogjtë e rritur në izolim për qëllime të gjuetisë dhe jo për prodhimin e mishit janë të përjashtuar.

STATISTIKAT KRYESORE:

Njësia blegtorale (NJB) është një njësi standarde e matjes, që lejon agregimin e kategorive të ndryshme të kafshëve, me qëllim që të mundësohet që ato të krahasohen ndërmjet viteve ose ndërmjet vendeve të ndryshme. Një NJB përfaqëson kafshët me peshë të gjallë prej 500 kg. NJB-ja e përdorur është e harmonizuar me BE-në.

Sipërfaqja e shfrytëzuar bujqësore i referohet sipërfaqes së përgjithshme të tokës së punueshme, kullotave të përhershme, kulturave të përhershme dhe kopshteve të përdorura nga EB-ja, pavarësisht nga lloji i zotërimit ose nëse ajo shfrytëzohet si pjesë e tokës së përbashkët.

Njësia e punës vjetore (NPV) nënkupton punësimin ekuivalent me punësimin me orar të plotë, d.m.th gjithsej orët e punës, të pjesëtuara me mesataren e orëve të punës gjatë vitit, në punë me orar të plotë, brenda vendit. Me orar të plotë do të thotë orët minimale të kërkuara me dispozitat kombëtare, që i rregullojnë kontratat e punësimit. Si orë minimale janë marrë 1 800 orë pune (225 ditë pune, nga tetë orë në ditë).

2. Vlerësimi i cilësisë së Regjistrimit të Bujqësisë

Burim kryesor për vlerësimin e cilësisë së të dhënave të mbledhura të RB 2014 ishte Anketa Pas Regjistrimit (APR). APR është realizuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Të dhënat janë mbledhur nga 1-15 dhjetor 2014 duke përdorur pyetësorë në letër për regjistrimin e të dhënave në intervistat ballë për ballë. Në zonat rurale të dhënat janë mbledhur duke përdorur metodën derë-më-derë, ndërsa në zonat urbane kornizë për mbledhjen e të dhënave ishte lista e ekonomive nga Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave 2011.

Qëllimi i Anketës Pas Regjistrimit është që t'iu ofrojë përdoruesve vlerësimin e cilësisë së rezultateve të regjistrimit. Vlerësimi i cilësisë së të dhënave të regjistrimit është marrë nga kryerja e një anketë mostër të vogël (deri në 1%), e cila ishte zbatuar një muaj pas përfundimit të regjistrimit.

Korniza unike referuese e mostrës që ishte në dispozicion për të nxjerrë mostrën ishte bazuar në versionin e fundit të Regjistrimit të Popullsisë 2011. Dizajni i mostrës ishte definuar veçmas për zonat rurale dhe ato urbane.

30 QR ishin përzgjedhur në mostër. Pjesa veriore e Kosovës nuk ishte përfshirë në mostër. Është marrë parasysh një madhësi e vogël e mostrës për një kufizim më të madh të APR në Kosovë dhe për të kufizuar vlerësimin e saj në nivel kombëtar.

Vlerësimi i gabimeve të mëposhtme janë synimet kyçe të APR-së:

- **Mbulueshmëria e gabimeve.** Fokusi kryesor është në nën-mbulueshmërinë; pra në identifikimin e anëtarëve të popullsisë së synuar, që nuk janë regjistruar gjatë grumbullimit të të dhënave të regjistrimit.
- **Identifikimi i gabimeve.** Saktësia e identifikimit të variablave kontrollohet me mbledhjen e serishme të këtyre të dhënave nga njësitë e caktuara të mostrës.
- **Gabimet në matje.** Të dhënat për variablat kryesore janë mbledhur përsëri, duke shfrytëzuar intervistuesit më të mirë të vlerësuar gjatë regjistrimit. Dallimet në rezultatet e fituara mund të përdoren për vlerësimin e gabimit në matje dhe rrjedhimisht paragjykimin e rezultateve të regjistrimit.
- **Gabimet në mos-përgjigje.** Njësitë që nuk janë përgjigjur kontaktohen përsëri, me qëllim që të merren së paku disa informacione kyçe për ekonominë familjare bujqësore. Rezultatet përdoren për vlerësimin e mos-përgjigjeve të rezultateve të Regjistrimit.

2.1. Pyetësi i Anketës Pas Regjistrimit

Pyetësi i APR-së përfshin pyetje dhe informacione tjera për disa qëllime:

- Ri-anketimin e disa ekonomive familjare bujqësore të popullsisë së synuar të regjistrimit;
- Mundësinë e lidhjes së suksesshme më vonë të të dhënave duke marrë për bazë të dhënat e ekonomisë familjare, që përfshin numrin identifikues të ekonomisë familjare, emrin, emrin e babës/bashkëshortit dhe mbiemrin e kryefamiljarit të ekonomisë familjare, të dhënat identifikuese për komunën, vendbanimin, kodin e QR-së, kodin e ndërtesës nga harta, numrin e hyrjes dhe numrin e banesës;
- Vlerësimin e gabimeve në mbulueshmëri;
- Mundësimin e vlerësimit të gabimeve në matje duke mbledhur disa variabla kryesore dy herë në mënyrë të pavarur.

2.2. Dizajni i mostrës

Meqë qarqet regjistruese janë bukur heterogjene për nga madhësia e tyre, është vendosur që të merren qarqet që u janë caktuar regjistrueseve si njësi të marrjes së mostrës. Këtë qark, ne do ta quajmë Qark Regjistruese dhe do të shënojmë QR. Në tekstin e mëposhtëm termi njësi gjithmonë do t'i referohet QR-së.

Dizajni i mostrës është definuar ndaras për zonat rural dhe për ato urbane.

Karakteristikat kryesore të dizajnit të mostrës për zonat rurale:

- Korniza e mostrës është krijuar duke përjashtuar zonat urbane nga baza e dhënave të para-regjistrimit dhe pastaj duke marrë të gjitha QR-të nga lista e fituar
- Rajoni është përdorur për grupim të qartësuar (eksplicit)
- Komuna është përdorur për grupim të nënkuptuar (implicit)
- Madhësia e mostrës së synuar ishte 25 QR. Për shkak të rrumbullakësimit në fazën e ndarjes së mostrës, madhësia përfundimtare e mostrës ishte 26 QR.
- Ndarja proporcionale përdoret për ta shpërndarë mostrën nëpër grupe. Kështu, numri i njësive të mostrës (n_h) në grupe h është llogaritur si vijon:

$$n_h = \text{round}\left(\frac{N_h}{N} * 25\right), \text{ ku}$$

N_h ...numri i QR-ve në grupin N_h

N ... numri i QR-ve në kornizë

- Korniza është organizuar sipas rajonit dhe komunës

Mostra e shpërndarë është përzgjedhur duke përdorur marrjen sistematike të mostrave brenda çdo grupi.

2.3. Mbledhja e të dhënave në APR

Për qëllime statistikore, Kosova është ndarë në shtatë rajone “të administruara statistikiisht”, ku secili prej tyre ka zyre rajonale të ASK-së, që kryesisht merret me mbledhjen e të dhënave.

Gjatë implementimit të regjistrimit, një regjistruer ishte caktuar në një ose më shumë qarqe të regjistrimit, varësisht nga numri i ekonomive familjare. Në Regjistrimin e Bujqësisë, numri i ekonomive familjare që i janë caktuar një regjistruer ka ndryshuar varësisht nga zonat urbane dhe rurale.

Organizimi i APR-së ishte mbështetur plotësisht në këtë strukturë ekzistuese për të ngritur në maksimum cilësinë e intervistave të kryera në terren. Stafit për mbledhjen e të dhënave të APR-së përbëhej nga grupi i metodologjisë së ASK-së në Prishtinë me mbikëqyrje të rregullt, ku secili prej tyre kanë mbuluar shtatë rajonet dhe regjistruerit kanë kontribuar në të shtatë rajonet e Kosovës.

Në implementimin APR-së janë përfshirë dy nivele të punës së stafit në terren.

Regjistruer - regjistruer është personi i cili bashkëvepron shumë ngushtë me publikun dhe mbledh të dhënat e APR-së për ekonomitë familjare bujqësore brenda qarqeve të regjistrimit që i janë caktuar atij/asaj. Regjistruerit janë përzgjedhur në bazë të përvojës së tyre në mbledhjen e të dhënave për anketa. Kryesisht janë përzgjedhur regjistruerit më të mirë të cilat kanë qenë duke punuar gjatë procesit të Regjistrimit të Bujqësisë, duke marrë parasysh edhe njohuritë e tyre për qarkun që do të mbulohej dhe përkatësinë etnike të komunitetit në atë qark. Kriteri i përzgjedhjes ka qenë kushti që regjistruerit të mos ketë punuar në qarkun e njëjtë të regjistrimit gjatë Regjistrimit të Bujqësisë. Secili regjistruer ishte përgjegjës për një qark të caktuar të regjistrimit të APR-së. Cilësia dhe performanca e punës së regjistruerëve janë monitoruar dhe kontrolluar për së afërm gjatë tërë procesit të APR-së. Secili regjistruer ka qenë përgjegjës për qarkun e tij/saj të regjistrimit. Gjithsej 30 regjistruer kanë qenë të angazhuar.

Mbikëqyrësi – ishte personi përgjegjës për menaxhimin e 3-4 regjistruerëve të APR-së. Mbikëqyrësi ka punuar shumë ngushtë me regjistruerit gjatë punës së tyre. Mbikëqyrësi ishte përgjegjës për të mbështetur regjistruerit në kryerjen e punës së tyre në mënyrë efikase, për t’i ndihmuar ata në rast të vështirësive dhe për të ushtruar kontrole të caktuara me qëllim të sigurimit se puna e tyre është e drejtë si dhe për të ofruar mbështetjen në aspektin administrativ dhe logjistik.

Ai/ajo ishte personi që i ka raportuar ekipit të APR-së. Roli i mbikëqyrësit ishte që të ndihmojë në korrigjimin e gabimeve dhe të sigurojë një progres të kënaqshëm gjatë periudhës së regjistrimit. Gjithsej 8 mbikëqyrës kanë qenë të angazhuar.

Para fillimit të punës së APR-së në terren, ekipi i APR-së në kuadër të ASK-së ka organizuar një trajnim dyditor për mbikëqyrësit dhe regjistruerit në terren. Është mbajtur komunikim i përditshëm me stafin në terren. Puna në terren ishte monitoruar nga personeli i metodologjisë i ASK-së, i cili iu ka dhënë sqarime shtesë kurdoherë që ka qenë e nevojshme.

APR është kryer gjatë periudhës 1-15 dhjetor 2014.

Të dhënat e mbledhura iu referohen periudhave në vijim:

- Shfrytëzimi i tokës, një (1) vit bujqësor, nga 31 tetor 2013 deri më 1 nëntor 2014;
- Gjedhet, 1 nëntor 2014;
- Fuqia punëtore, një (1) vit bujqësor, nga 31 tetor 2013 deri më 1 nëntor 2014;

Për mbledhjen e të dhënave është shfrytëzuar metoda e intervistimit ballë-për ballë.

2.4. Përfshirja dhe pastrimi i të dhënave

Përfshirja e të dhënave dhe përpunimi i të dhënave të rezultateve të APR-së janë kryer në të njëjtën kohë me përfshirjen e të dhënave të regjistrimit. Të dhënat e APR-së janë përfshirë në mënyrë manuale nga operatorët e përzgjedhur për përfshirjen e të dhënave duke shfrytëzuar aplikacionin për përfshirjen e të dhënave që ishte përgatitur nga ekspertët e TI-së. Aplikacioni për përfshirjen e të dhënave ishte zhvilluar sipas specifikacioneve të shtjelluara nga APR-ja dhe personeli i metodologjisë.

2.5. Aplikacioni për përfshirjen e të dhënave të APR-së

Aplikacioni për përfshirjen e të dhënave të APR-së është krijuar në MS Access dhe VB (Visual Basic). Baza e të dhënave e shfrytëzuar për këtë aplikacion është My SQL.

Aplikacioni ishte dizajnuar për të mbështetur përfshirjen e dyfishtë të të dhënave dhe verifikimin e të dhënave numerike të bazuar në gjithsej (verifikim i dyfishtë).

Në përfshirjen e dytë të të dhënave, përfshirja e dyfishtë e të dhënave ka siguruar verifikimin e çdo të dhëne të përfshirë gjatë përfshirjes së parë.

3. Dimensionet e cilësisë dhe treguesit e cilësisë së RB 2014

3.1. Relevanca

Relevanca është një veçori e statistikave që mat se në çfarë shkalle të dhënat statistikore i plotësojnë nevojat e tanishme dhe potenciale të shfrytëzuesve. Relevanca është matur me disponueshmërinë e treguesve që nevojiten nga përdoruesit dhe se në çfarë mase të dhënat e shpërndara dhe konceptet e përkufizimet e ndërlydhura përshtaten me nevojat e përdoruesve.

Përdoruesit kryesor të të dhënave

Përdoruesit kryesor të të dhënave janë si në vijim:

- Qeveria
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR),
- Institucionet kërkimore dhe universitetet
- Administratat komunale

Komunikimi me përdoruesit e të dhënave

Komunikimi me përdoruesit e të dhënave është kryer nëpërmjet kanaleve të ndryshme:

- Konferencave për shtyp
- Përfshirjes së përdoruesve kryesor në Komisionin për Regjistrim
- Takimeve të Komisionit për Regjistrim
- Përfshirjes së një anëtari të MBPZHR-së në grupin punues të metodologjisë së RB-së
- Përfshirjes së stafit të MBPZHR-së në Komisionet Komunale

3.2. Pjesa e statistikave që mungojnë

Të gjitha të dhënat e kërkuara sipas Rregullores (EC) 1166/2008 ishin mbledhur përveç të dhënave lidhur me fenomenet e parëndësishme dhe joekzistuese në Kosovë.

Përveç kësaj, disa të dhëna janë mbledhur për nevoja kombëtare. Këto të dhëna kanë qenë: të dhënat për numrin e pemëve frutore/hardhive (gjithsej numri i pemëve në moshë produktive), të dhënat të hollësishme për makinat dhe pajisjet sipas vjetërsisë dhe pronësisë, të dhënat për objektet bujqësore përveç atyre për strehimin e kafshëve dhe të dhënat për prerjen dhe përpunimin e drurit në fermë.

4. Saktësia e vlerësimeve

Saktësia e rezultateve statistikore në kuptim të përgjithshëm statistikor është shkalla e afërsisë së llogaritjeve apo vlerësimeve me vlerat e sakta apo të vërteta që statistikave kanë pasur për qëllim të nxjerrin.

4.1. Gabimet në mostër (Sampling errors)

Në Regjistrimin e Bujqësisë, të dhënat për të gjitha variablat ishin mbledhur nga të gjitha njësitë në kornizë, prandaj llogaritja e gabimeve në mostër nuk është një faktor relevant.

4.2. Gabimet jo në mostër (Non sampling errors)

Gabimi jo në mostër është gabimi që rrjedh si rezultat i faktorëve të tjerë e jo faktit që anketa është zbatuar në bazë të mostrës.

Gabimet jo në mostër, të cilat zbatohen për të gjitha proceset statistikore, mund të karakterizohen si:

- gabime në mbulueshmëri;
- gabimet e mos-përgjigjes;
- gabimet në matje; dhe
- gabimet në përpunim.

4.3. Gabimi i mospërgjigjes

Gabimet e mospërgjigjes ndodhin kur anketa nuk arrin të marrë përgjigje në një apo në të gjitha pyetjet.

4.4. Shkalla e mospërgjigjes së njësisë

Norma e mospërgjigjes së njësisë i referohet shkallës së numrit të njësive pa informacione apo me informacione jo të përdorshme (mospërgjigje, etj.) në gjithsej numrin e njësive të pranueshme (të kualifikueshme-ekonomi bujqësore). Shkalla mund të jetë e peshuar dhe e papeshuar.

Tabela 1: Shkalla e mospërgjigjes (e papeshuar)

Numri i njësive të kualifikueshme	134 009
Numri i mospërgjigjeve	3 716
Shkalla e mospërgjigjes (%)	2.8

Tabela 2: Shkalla e papeshuar dhe e peshuar e mospërgjigjes së njësisë sipas rajonit

Emri i rajonit	Shkalla e papeshuar e mospërgjigjes (%)	Shkalla e peshuar e mospërgjigjes (%)
Kosovë	2.8	2.4
Prishtinë	3.6	3.1
Mitrovicë	2.3	1.9
Pejë	1.8	1.3
Prizren	2.6	2.5
Ferizaj	1.7	1.4
Gjilan	4.6	4.3
Gjakova	2.0	1.9

Si njësi matëse në llogaritjen e shkallës së peshuar të përgjigjes janë shfrytëzuar të dhënat për sipërfaqen e shfrytëzuar bujqësore të mbledhura në Regjistrimin e Popullsisë dhe Banesave 2011. Shkalla e peshuar e mospërgjigjes së llogaritur i referohet vetëm 34 komunave të cilat kanë marrë pjesë në RB; 4 komunat jopjesëmarrëse nuk janë përfshirë në këtë llogaritje.

4.5. Shkalla e pastrimit dhe imputimit

Shkalla e pastrimit dhe imputimit për variablen kryesore të përzgjedhur është shkalla e njërive për të cilën ka ndryshuar vlera e variables gjatë procesit të pastrimit, qoftë përmes korrigjimeve të theksuara ose me anë të procedurave të imputimit. Shkalla e peshuar e pastrimit dhe imputimit është llogaritur si shkallë ndërmjet totalit të vlerave të ndryshuara në totalin e të gjitha vlerave.

Tabela 3: Shkalla e pastrimit dhe imputimit për variablat kryesore të RB-së

Variablat kryesore	Shkalla (%)
Tokë e punueshme	5.36
Drithëra kokërr	0.25
Patate	0.48
Sipërfaqe me vreshta	4.58
Sipërfaqe me plantacione të pemëve	30.88
Livadhe dhe kullota të përhershme (pa tokën e përbashkët)	8.33
Lopët (të gjitha lopët)	0.02
Dele për mbarsim (femra)	0.83
Dhi për mbarsim (femra)	0.19

Në tabelën në vijim ne paraqesim ndikimin që procedurat e pastrimit dhe imputimit kanë në disa prej rezultateve statistikore kryesore, të vlerësuara dhe të shpërndara në RB. Ky tregues është llogaritur si një ndryshim relativ i statistikave kryesore, të llogaritura para dhe pas procesit të pastrimit dhe imputimit. Vlera pozitive e treguesve nënkupton se vlera e statistikave është rritur pas procesit të pastrimit dhe imputimit dhe është zvogëluar në rast të vlerave negative.

Tabela 4: Ndikimi i procedurave të pastrimit dhe imputimit në statistikat kryesore të RB-së

Statistikat kryesore (totalët e variablave kryesore)	Ndryshimi relativ (%)
Tokë e punueshme	0.23
Drithëra kokërr	-0.35
Patate	-0.76
Sipërfaqe me vreshta	0.80
Sipërfaqe me plantacione të pemëve	2.94
Livadhe dhe kullota të përhershme (pa tokën e përbashkët)	6.08
Lopët (të gjitha lopët)	1.21
Dele për mbarsim (femra)	0.03
Dhi për mbarsim (femra)	-4.97

4.6. Trajtimi i mospërgjigjes së njësive

Për vlerat që mungojnë janë shfrytëzuar metoda të ndryshme të imputimit; kryesisht metodat hot deck dhe ajo e shkallës mesatare. Imputimet ishin implementuar me anë të një aplikacioni, i cili ka shfrytëzuar të ashtuquajturën qasjen 'Meta data driven'.

4.7. Gabimi në mbulueshmëri

Gabimet në mbulueshmëri janë gabime që rrjedhin për shkak të mos-përfshirjes apo duplikimeve të njësive në procesin e regjistrimit.

4.7.1. Gabimi në mbi-mbulueshmëri të kornizës

Mbi-mbulueshmëria: Njësi që gjenden në kornizë e të cilat nuk i përkasin popullsisë së synuar.

Shkalla e mbi-mbulueshmërisë: Shkalla e mbi-mbulueshmërisë është proporcioni i njësive që janë në kornizë e që nuk i përket popullatës së synuar (janë jashtë fushëveprimit).

Tabela 5: Shkalla e mbi-mbulueshmërisë së kornizës

Numri i njësive në kornizë:	210 910
Numri i njësive jo të kualifikueshme	76 901
Shkalla e mbi-mbulueshmërisë (%)	36.5

Korniza e shfrytëzuar për RB ishte bazuar në Regjistrimin e Popullsisë dhe Banesave 2011. Gjatë Regjistrimit Testues të Bujqësisë në vitin 2012, është gjetur se jo të gjitha ekonomitë familjare janë përfshirë në listë nga Regjistrimi i Popullsisë 2011. Me qëllim që të kemi një mbulueshmëri të mirë në RB në zonat rurale, në kornizë janë përfshirë të gjitha ekonomitë familjare. Përveç kësaj,

regjistruesit kanë qenë të obliguar që të identifikojnë të gjitha ekonomitë e reja familjare në terren, madje edhe nëse ato nuk kanë qenë të përfshira në bujqësi. Shumë nga ekonomitë e cekura në list, gjatë RB janë shfaqur sikur të kenë qenë të përfshira në bujqësi dhe ato paraqesin mbi-mbulueshmërinë e kornizës.

4.7.2. Gabimi i nën-mbulueshmërisë dhe mbi-raportimit

Nën-mbulueshmëria i referohet njësive që nuk kanë qenë të përfshira në kornizë, por të cilat është dashur të jenë.

Regjistrimi i Bujqësisë nuk ka mundur të kryhet në katër komuna në veri të Kosovës (Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut), për shkak se këto komuna refuzuan të marrin pjesë. Rezultatet finale të Regjistrimit të Bujqësisë përfshijnë të dhënat për 34 komuna.

Në pjesën e Kosovës, ku është implementuar RB-ja, mbulueshmëria për sa i përket variablave kryesore është vlerësuar duke shfrytëzuar formulën e mëposhtme për shkallën e nën-mbulueshmërisë:

$$UCR = \frac{\sum_{i \in U} w_i}{\sum_{j \in P} w_j}$$

ku w_i është pesha e njësisë, U është bashkësi e të gjitha njësive që janë vrojtuar (mbi pragun) në APR, por që nuk janë vrojtuar në regjistrim (refuzim, nën prag, jo te kualifikueshme).

Kur është bërë krahasimi i të dhënave të APR-së dhe të regjistrimit, është identifikuar një fenomen tjetër lidhur me problemin e mbulueshmërisë. Ne e kemi quajtur këtë fenomen mbi-raportim dhe ai është vlerësuar duke shfrytëzuar formulën në vijim:

$$OVC = \frac{\sum_{i \in C} w_i}{\sum_{j \in P} w_j}$$

ku w_i është pesha e njësisë, C është bashkësi e të gjitha njësive që janë vrojtuar (mbi pragun) në RB, por të identifikuar si 'nën pragut' në APR, dhe P është bashkësi e njësive¹ të përputhura.

Për të vlerësuar ndikimin e të dy gabimeve të lartpërmendura, nën-mbulueshmërisë dhe mbi-raportimit, është vlerësuar një tregues tjetër. Shkalla neto e mbulueshmërisë është vlerësuar duke shfrytëzuar formulën e mëposhtme:

$$NC = \frac{\sum_{i \in E} w_i - \sum_{i \in C} w_i}{\sum_{j \in P} w_j}$$

ku w_i është pesha e njësisë, E është bashkësi e njësive të përputhura që janë identifikuar të jenë mbi prag në APR dhe janë gjetur nën prag në RB, ku C është bashkësi e të gjitha njësive që janë identifikuar mbi prag në RB dhe janë gjetur nën prag në APR. P është bashkësi e të gjitha njësive të përputhura.

¹ Njësitë në nivel individual kanë qenë të përputhura në mënyrë të suksesshme me të dy burimet.

Tabela 6. Shkalla e nën-mbulueshmërisë, shkalla e mbi-mbulueshmërisë dhe shkalla neto e mbulueshmërisë

Variablat kryesore	Nën-mbulueshmëria (%)	Mbi-raportimi (%)	Mbulueshmëria neto (%)
Numri i ekonomive bujqësore	5.30	3.50	0.01
Toka e punueshme e shfrytëzuar-sipërfaqja kryesore	4.73	2.79	-0.49
Sipërfaqja me grurë (kokërr)	4.53	2.44	-0.60
Sipërfaqja me misër (kokërr)	5.05	1.50	0.95
Sipërfaqja me patate	18.78	0.24	15.24
Sipërfaqja me perime	5.77	2.48	2.46
Sipërfaqja me plantacioneve të vreshtave	0.46	6.82	-6.37
Sipërfaqja me plantacione të pemëve	16.81	10.80	3.98
Sipërfaqja me livadheve dhe kullota të përhershme në shfrytëzim (pa tokën e përbashkët)	4.78	2.56	1.38
Gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar bujqësore (pa tokën e përbashkët)	4.92	2.79	0.30
Gjedhe	2.75	0.61	1.69
Lopë qumështore	2.52	0.89	1.21
Dele femra për mbarsim	0.00	0.00	0.00
Dhi femra për mbarsim	0.55	0.00	0.55
Gjithsej shpezë	5.35	3.67	-1.34

Gabimi i vlerësuar i nën-mbulueshmërisë tregon se në bazën e të dhënave të RB-së mungojnë 5.3% e ekonomive bujqësore në zonat rurale; ekonomitë bujqësore ekzistojnë, por nuk janë identifikuar si ekonomi bujqësore në regjistrim. Kjo do të ketë ndikim në shfrytëzimin e ardhshëm të bazës së të dhënave të RB-së si kornizë për mostra. Megjithatë, gabimi i identifikuar i mbi-raportimit bën një balancim të gabimit të nën-mbulueshmërisë për shumatat e përgjithshme që kanë të bëjnë me variablat kryesore. 3.5% e ekonomive bujqësore në bazën e të dhënave të RB-së ishin identifikuar në APR se nuk i kanë plotësuar kriteret e ekonomisë bujqësore, prandaj ato nuk duhet të jenë pjesë e bazës së të dhënave të RB-së. Mund të konkludojmë se prezenca e saj kompenson deri në një masë të madhe nën-mbulueshmërinë e identifikuar. Duke marrë parasysh gabimin e nën-mbulueshmërisë dhe mbi-raportimit, ndryshimi në numrin e ekonomive bujqësore dhe sipërfaqen e shfrytëzuar bujqësore është pothuajse i pavërejtur (më pak se 0.5%).

4.8. Gabimet në matje

Gabimet në matje mund të ndodhin në faza të ndryshme dhe për arsye të ndryshme. Ato mund të definojnë si një shmangje ndërmjet vlerës së regjistruar të dhënë nga respondentit (e cila nuk mund të jetë vlera aktuale) dhe vlerës së vërtetë por të panjohur të variablave të dhëna. Burimet kryesore të këtyre gabimeve janë në mënyrë tipike anketa dhe procesi mbledhjes së të dhënave në përgjithësi.

Arsyet më të zakonshme për gabimet në matje mund të karakterizohen në tri kategori kryesore:

- Pamjaftueshmëritë e instrumenteve të anketës (në rastin tonë pyetësi);
- Informacionet e gabuara (me dashje apo pa dashje) të dhëna nga respondentit;
- Informacionet e gabuara për shkak të ndikimit të intervistuesit.

Gabimi në matje ishte vlerësuar sipas strukturës së njësive të APR-së dhe regjistrimit të cilat ishin përputhur në mënyrë të suksesshme. Janë llogaritur ndryshimet e vlerave të regjistruara të variablave kryesore në të dy burimet, dhe ndryshimi relativ në nivel të popullsisë ishte llogaritur duke marrë parasysh peshat bruto. Gabimi në matje ishte vlerësuar vetëm për zonat rurale pasi që mostra e APR-së nuk ishte reprezentative për zonat urbane. Në rast të ndryshimeve të mëdha në nivel individual, të dhënat ishin verifikuar me anë të metodës së ri-thirrjes. Pasi që ndryshimi relativ ishte llogaritur në bazë të mostrës së rastit, edhe koeficienti i variacionit (ndryshimit) ishte vlerësuar për çdo llogaritje.

Tabela 7. Gabimi në matje për variablat kryesore

Variablat kryesore	(APR – RB)/APR (%)	KV (%)
Toka e punueshme e shfrytëzuar-sipërfaqja kryesore	-1.14	5.1
Sipërfaqja me grurë (kokërr)	-1.09	6.2
Sipërfaqja me misër (kokërr)	1.05	9.9
Sipërfaqja me plantacioneve të vreshtave	-9.05	10.7
Sipërfaqja me plantacione të pemëve	4.85	18.3
Sipërfaqja me livadheve dhe kullota të përhershme në shfrytëzim (pa tokën e përbashkët)	6.40	5.4
Gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar bujqësore (pa tokën e përbashkët)	1.70	3.9
Gjedhe	-1.73	2.03
Lopë qumështore	0.21	1.64
Dele femra për mbarsim	-1.22	14.89
Dhi femra për mbarsim	8.44	13.12
Gjithsej shpezë	-2.30	3.77

Gabimi në matje është paraqitur vetëm për vlerësimet për të cilat koeficienti i variacionit (ndryshimit) është më pak se 20 %.

4.8.1. Burimi i gabimeve në matje

Burimet potenciale të gabimeve në matje ishin vlerësuar. Nga APR mund të konkludohet se performanca e regjistruarve ishte burim i gabimit. Arsyet mund të jenë të ndryshme. Supozohet se trajnimi i regjistruarve dhe monitorimi i regjistruarve mund të ishin problemi kryesor. Përkundër faktit se janë mbajtur pesë ditë trajnim, me gjasë kanë munguar disa informacione apo ato janë interpretuar gabimisht në kuadër të sistemit kaskadë të trajnimit. Burim i gabimit në matje po

ashtu mund të ketë rrjedhur për shkak të dominimit të fermave të vogla, të cilat nuk prodhojnë për treg dhe nuk i dinë saktësisht të dhënat në lidhje me shfrytëzimin e tokës, prandaj bëjnë një vlerësim të sipërfaqes.

4.8.2. Trajtimi i gabimeve në matje

Ato gabime në matje që ishin identifikuar si mospërputhje gjatë vlefshmërisë së të dhënave ishin korrigjuar gjatë procesit të pastrimit të të dhënave. Një sasi e vogël e vlerave jo të përafërta ishin verifikuar duke i ri-kontaktuar fermerët me telefon, dhe ato ishin korrigjuar në mënyrë individuale sipas nevojës. Megjithatë, shumica e gabimeve ishin korrigjuar duke shfrytëzuar korrigjimet sistematike dhe automatike. Për identifikimin dhe korrigjimin e gabimeve ishte shfrytëzuar një aplikacion, që bazohet në qasjen 'Meta data driven'.

4.8.3. Masat e ndërmarra për zvogëlimin e gabimeve në matje

Implementimi i RB-së ka përfshirë shumë aktivitete me qëllim të minimizimit të gabimeve në matje. Aktivitetet kryesore në këtë aspekt ishin:

- Testimi i të gjitha instrumenteve të regjistrimit në regjistrimin testues 2 vite para se të kryhet RB,
- Trajnimi i stafit në terren,
- Monitorimi i stafit në terren,
- Trajnimi i stafit për përfshirje të të dhënave,
- Monitorimi i përfshirjes së të dhënave

5. Afatet kohore dhe përpikëria

5.1. Afatet kohore

Afatet kohore përshkruajnë gjatësinë kohore ndërmjet disponueshmërisë së të dhënave dhe ngjarjes apo fenomenit që ato përshkruajnë.

Tabela 8: Afatet kohore të rezultateve të para

Periudha referuese:	01.11.2014
Data e publikimit:	28.2.2015
Intervali kohor (muaj):	4 muaj

Tabela 9: Afatet kohore të rezultateve përfundimtare

Periudha referuese:	01.11.2014
Data e publikimit:	26.11.2015
Intervali kohor (muaj):	13 muaj

5.2. Përpikëria

Përpikëria është intervali kohor ndërmjet publikimit aktual të të dhënave dhe datës së synuar në të cilën ato ishin planifikuar që të publikohen ashtu siç ishte njoftuar në kalendarin zyrtar të publikimit të përcaktuar me Rregullore apo siç është dakorduar paraprakisht ndërmjet partnerëve.

Tabela 10: Përpikëria e rezultateve përfundimtare

Periudha referuese:	01.11.2014
Data e paraparë e publikimit:	30.09.2015
Data e publikimit:	26.11.2015
Vonesa në kohë (ditë):	57 ditë

5.3. Arsyet për vonesa dhe masat e ndërmarra për shkurtimin e vonesave

Koha për pastrimin dhe analizimin e të dhënave ishte e kufizuar nga korniza e projektit dhe ishte jashtëzakonisht e shkurtër. Në fazën e analizimit janë identifikuar probleme të cilat është dashur të zgjidhen dhe për këtë është nevojitur kohë shtesë.

6. Qasja dhe qartësia

Qasja dhe qartësia i referohen thjeshtësisë dhe lehtësisë, kushteve dhe modaliteteve me anë të të cilave përdoruesit mund t'iu qasen, shfrytëzojnë dhe interpretojnë statistikën, me informacionet dhe asistencën e duhur mbështetëse.

6.1. Qasja

Qasja është një veçori e statistikave që përshkruan një varg kushtesh dhe modalitetesh me anë të të cilave përdoruesit mund t'i marrin të dhënat. Sipas Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, statistikën evropiane duhet të paraqiten në një formë të qartë dhe të kuptueshme, të shpërndara në mënyrë të përshtatshme dhe të volitshme, të disponueshme dhe të qasshme me paanësi dhe me informacione përshkruese dhe udhëzime mbështetëse.

Publikimi me rezultatet kryesore ishte në dispozicion përmes internetit në kohën e shpërndarjes së të dhënave. Publikimet, tabelat dhe materialet e ASK-së për kumtesë, për shtyp janë gjithmonë në dispozicion në të tri gjuhët: shqip, anglisht dhe serbisht. Tabelat gjithashtu janë në dispozicion në platformën për shpërndarjen e të dhënave përmes internetit, të quajtur ASKDATA. Përdoruesit nuk kanë qasje të drejtpërdrejt në mikro të dhënat, por me ligj hulumtuesit dhe institucionet mund të kërkojnë qasje nëpërmjet ASK-së.

6.2. Qartësia

Qartësia është një veçori e statistikave që përshkruan se në ç'masë informacionet përshkruese gjithëpërfshirëse janë lehtësisht të disponueshme, kur këto informacione përshkruese nevojiten për t'iu dhënë një kuptim të plotë të dhënave statistikore. Qartësia nganjëherë referohet edhe si "interpretueshmëri". Ajo i referohet mjedisit të informacioneve të të dhënave, nëse të dhënat janë të shoqëruara me informacione të duhura përshkruese, duke përfshirë informacionet rreth cilësisë së tyre, dhe se në ç'masë përdoruesve iu ofrohet asistencë shtesë nga ana e ofruesve të të dhënave. Në Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane, qartësia kryesisht është e lidhur me qasjen më qëllim të formimit të një kriteri të vetëm të cilësisë: "qasja dhe qartësia": kushte dhe modalitete këto me anë të të cilave përdoruesit mund të përdorin dhe interpretojnë të dhënat.

Të gjitha definicionet dhe treguesit e variablave janë në dispozicion të shfrytëzuesve në formë të publikimit të printuar dhe në formë të publikimit në web faqe. Udhëzimet metodologjike dhe pyetësi janë në dispozicion në web faqe. Përveç kësaj, treguesit kryesor të cilësisë (shkalla e mospërgjigjes, shkalla e nën-mbulueshmërisë dhe gabimi në matje) janë paraqitur në publikim ku të dhënat kryesore janë publikuar si dhe raporti i cilësisë është në dispozicion për përdoruesit në versionin e printuar dhe në web faqe. ASK-ja ofron shpjegime shtesë me kërkesë të përdoruesve. Kërkesat ad hoc janë trajtuar nga Departamenti i Statistikave Bujqësore të ASK-së.

7. Krahasueshmëria

Krahasueshmëria është një matje e ndikimit të ndryshimeve në konceptet e aplikuara statistikore, mjetet e matjes dhe procedurat kur statistikant krahasohen ndërmjet zonave gjeografike ose në kohë.

7.1. Krahasueshmëria në kohë

Regjistrimit i fundit i bujqësisë i kryer në vitin 1960 nuk është i krahasueshëm me RB 2014 për shkak të ndryshimeve metodologjike, për shkak të ndryshimeve të mëdha që kanë ndodhur gjatë asaj periudhe (lufta, pavarësia në vitin 2008), dhe për shkak të ndryshimeve në zonat gjeografike të mbuluara. Të dhënat e RB-së po ashtu nuk janë plotësisht të krahasueshme me anketën vjetore për ekonominë familjare bujqësore, si për shkak të ndryshimeve në përkufizime ashtu edhe ndryshimeve në mbulueshmëri gjeografike.

7.2. Krahasueshmëria gjeografike

Përderisa RB në vitin 1960 dhe anketa e ekonomive familjare bujqësore mbulojnë tërë territorin e Kosovës, në RB 2014 katër komuna nuk janë përfshirë. Përkundër të gjitha përpjekjeve, katër komunat në veri (Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok dhe Mitrovicë e Veriut), me popullsi shumicë serbe nuk kanë marrë pjesë në regjistrim.

Metodologjia e Regjistrimit të Bujqësisë 2014 ishte në përputhje me standardet ndërkombëtare; Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë (ang. FAO) dhe me legjislacionin e BE-së: Rregulloren (EC) Nr. 1166/2008 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian për anketat e strukturës së fermës dhe anketën për metodat e prodhimit bujqësor, si dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit Evropian (EEC) 571/88. Të dhënat janë të krahasueshme me shtetet e BE-së dhe me ato që kryejnë RB në bazë të rekomandimeve të FAO-s.

8. Koherenca

Koherenca mat përshtatshmërinë e statistikave që do të kombinohen në mënyra të ndryshme dhe për përdorime të ndryshme.

8.1. Koherenca e brendshme

Shkalla në të cilën statistikat janë konsistente me strukturën e caktuar të të dhënave.

Tabela 11: Ndryshimi ndërmjet të dhënave të përkohshme dhe përfundimtare

Statistikat	Ndryshimi (%) për sa i përket rezultateve të para
Numri i ekonomive bujqësore	1.2
Sipërfaqja e shfrytëzuar bujqësore (pa tokën e përbashkët) (ha)	3.2
Gjithsej gjedhe	3.2
Gjithsej dele	-2.3
Gjithsej dhi	7.4
Gjithsej shpezë	-0.1

Arsyet për ndryshime ndërmjet rezultateve të para dhe rezultateve përfundimtare:

- Për nxjerrjen e rezultateve të para janë shfrytëzuar të dhënat nga Raportet Ditore;
- Gjatë fazës së pastrimit të të dhënave janë shfrytëzuar edhe të dhënat administrative në dispozicion me qëllim të verifikimit të mbulueshmërisë, veçanërisht mbulueshmërisë së njësive juridike;
- Janë shfrytëzuar burimet e mëposhtme administrative:
- Regjistri i blegtorisë nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë

- Regjistri i vreshtarisë nga MBPZHR
- Të dhënat mbi subvencionet nga MBPZHR

Burimet administrative janë harmonizuar me bazën e të dhënave të RB-së dhe të gjitha njësitë mbi pragun e përcaktuar janë kontaktuar më qëllim të verifikimit të ekzistimit të tyre në bazën e të dhënave të RB-së. Të gjitha njësitë të cilat ishin verifikuar se nuk kanë qenë të vrojtuar gjatë punës në terren në nëntor 2014 ishin intervistuar me telefon gjatë shtatorit 2015.

8.2. Koherenca me burimet tjera

Shkalla në të cilën statistikat janë në pajtueshmëri me ato të siguruara përmes burimeve tjera të të dhënave apo domeneve statistikore.

Tabela 12: Ndryshimi ndërmjet të dhënave përfundimtare të RB-së dhe anketës së ekonomive familjare bujqësore (AEFB)

Variablat kryesore	AEFB	RB	Ndryshim (në %) për sa i përket AEFB-së	Ndryshimi për sa i përket AEFB-së
Tokë e punueshme (ha)	191 059	180 381	-5.9	-10 678
Drithërat kokërr (ha)	141 912	131 949	-7.6	-9 963
Patate (ha)	2 777	3 694	24.8	917
Sipërfaqe me vreshta (ha)	1 647	3 215	48.8	1 568
Sipërfaqe me pemishte (ha)	3 720	4 390	15.3	670
Livadhe dhe kullota të përhershme (pa tokën e përbashkët) (ha)	92 393	76 823	-20.3	-15 570
Gjithsej gjedhe	321 384	261 689	-22.8	-59 695
Lopë (të gjitha lopët)	178 557	136 209	-23.7	-42 348
Dele për mbarsim (femra)	107 991	146 924	36.1	38 933
Dele për mbarsim (femra)	16 684	23 575	41.3	6 891

Të dhënat nga anketa e ekonomive familjare bujqësore nuk janë drejtpërsëdrejti të krahasueshëm me RB për shkak të arsyeve në vijim:

- Mostra për AEFB ishte përgatitur nga korniza e azhurnuar
- Anketa e AEFB-së është bazuar në mostër
- AEFB mbulon tërë Kosovën, ndërsa në RB mungojnë 4 komuna
- Disa përkufizime janë të ndryshme: për shembull në rastin e tokës së punueshme, në AEFB edhe ish-toka e punueshme e cila është shfrytëzuar si livadh i përhershëm është numëruar si tokë e punueshme. Në RB është përdorur përkufizimi i harmonizuar i BE-së (shih kapitullin e përkufizimeve të variablave).
- AEFB nuk ka mbuluar njësitë juridike bujqësore në mënyrë sistematike.

9. Kostoja dhe ngarkesa mbi të anketuarit

Kostoja dhe ngarkesa është kostoja e ndërlidhur me mbledhjen dhe prodhimin e produktit statistikor dhe ngarkesa mbi të anketuarit.

Tabela 13: Shpenzimet

Shpenzimet totale	4.9 milion euro*
Buxheti i regjistrimit (Fondi i Mirëbesimit)	4.7 milion euro
Kostoja e personelit të ASK-së	260 713 euro
Kostoja për ekonomi bujqësore	37.9 euro për ekonomi bujqësore

* Përfshin të gjitha shpenzimet për ekonomitë bujqësore dhe jobujqësore të përfshira në listë për tu anketuar.

10. Konfidencialiteti

Konfidencialiteti është karakteristikë e të dhënave që tregon se në ç'masë zbulimi i tyre i paautorizuar do të mund të ishte paragjykes dhe i dëmshëm për interesin e burimit apo të palëve tjera relevante.

Gjatë implementimit të RB-së, është vepruar në pajtueshmëri me të gjitha rregullat lidhur me konfidencialitetin të përcaktuar me Ligjin për Regjistrimin e Bujqësisë dhe Ligjin për Statistikat Zyrtare. Të gjitha tabelat e publikuara ishin kontrolluar për sa i përket zbulimit dhe të gjitha të dhënat ku ka mundur të ndodhë zbulimi për shkak të numrit të vogël të njësive apo për shkak të dominimit të një njësie nuk janë publikuar. Të dhënat individuale nuk janë në dispozicion të përdoruesve.